



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1384/1 Prot.

Vlorë më, 13.05.2026

VENDIM

Nr. 27, datë 13.05.2026

PËR
ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE, PËRFAQËSUES I
UNIVERSITETIT

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja "gj", dhe nenit 48, pika 1 dhe neni 50, pika 4, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 19, pika 1, shkronja "ll", dhe nenit 23, pika 3, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 13, pika 22, dhe nenit 14 të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", si dhe në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik nr. 19, datë 17.04.2026, pas përfundimit të procedurës së votimit për kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si përfaqësues të universitetit, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 13.05.2026,

VENDOSI

1. Të shpallë fitues dhe të zgjedhë z./znj. Ledina Mançka si anëtar të Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësues të universitetit.
2. Mandati i anëtarit të zgjedhur fillon menjëherë pas miratimit të këtij vendimi dhe është mandat plotësues deri në përfundimin e mandatit ekzistues.
3. Ky vendim i njoftohet Bordit të Administrimit për vijimin e procedurave të konstituimit dhe marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e tij.
4. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet për dijeni Ministrisë së Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

